



ADRIA



BLETËT, MË SHUMË SE MJALTË

NJË UDHËZUES PRAKTIK PËR TRAJNUESIT, I CILI DO TU ÇOJË NË BOTËN E BLETËVE. 2021

Publikuar nga:

WWF Adria – Serbia, Đure Jakšića 4a, 11000 Beograd
Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) -
Rr. Janos Hunyadi, Godina 32, Ap. 11, 1019, Tirana, Albania

Redaktuar nga:

Jovana Dragić May, Sonja Bađura

Autore:

Jovana Bila Dubaić

Përktheu në Gjuhën Shqipe:

Kimete Mazari

Redaktuar në Gjuhën Shqipe:

Ledi Selgjekaj, Klea Medini

Dizajn dhe ilustrimet nga:

Jelena Šušnjar, Jakov Ponjavić

Fotot nga:

Jovana Bila Dubaić

Kopertina nga:

Sanja Šovran

Kontakt:

serbia@wwfадria.org, contact@ppnea.org

Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) është një organizatë mjedisore jo qeveritare që operon në mbarë vendin, e njohur si organizata e parë mjedisore në Shqipëri.

Duke patur si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e llojeve të rrezikuar me rëndësi dhe zonave me vlera të larta të biodiversitetit, PPNEA është organizata implementuese e projektit “Zonat e Mbrojtura për Natyrën dhe Njerëzit II” në Shqipëri, në kuadër të të cilit është prodhuar ky material.



“Zonat e Mbrojtura për Natyrën dhe Njerëzit” është një projekt i financuar nga Sida (Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar). Ky udhëzues është krijuar në kuadër të projektit, dhe Sida jo domosdoshmërisht ndan të njëjtat pikëpamje të shprehura në këtë udhëzues. Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij udhëzuesi i mbetet plotësisht autores.

Përmbajtja

Hyrje	5
Pjalmimi	6
Bletët	6
Cilat janë bletët?	6
Si duken bletët? Si ti dallojmë ato nga insektet e tjerë të ngjashëm?	8
Si jetojnë bletët? A janë gjithë bletët insekte sociale dhe a jetojnë të gjitha në koshere?	12
Si është cikli jetësor i bletëve të vetmuara?	13
Ku i ndërtojnë zgjojet bletët?	14
Pse nuk mjafton të mbështetemi vetëm tek bletët e mjaltit?	17
Cilët janë faktorët që ndikojnë negativisht tek bletët?	17
Fragmentimi i habitatit dhe shkatërrimi	17
Ndryshimet klimatike	18
Bujqësia intensive	19
Llojet invazive, patogjenët dhe parazitët	20
Cilat do të ishin pasojat e zhdukjes së bletëve?	21
Çfarë mund të bëjmë ne për t'i ndihmuar bletët?	22
20 fakte rreth bletëve	26
Shtojca 1. Fletore Pune	30
Shtojca 2. Seminar se si të ndërtohen "hotele" për bletët	40
Seminar i përshtatur për moshat 5-8	40
Seminar i përshtatur për moshat 9-13 vjeç	45
Seminari i përshtatur për moshën 13 vjeç (adoleshentë dhe të rritur)	48
Këshilla praktike	52
Përgjigjet e duhura:	54

Hyrje

Në jetën e përditshme njerëzit mbështeten tek natyra, përdorin produktet e saj dhe proceset që ndodhin në natyrë. Për të theksuar të gjitha të mirat dhe “dhuratat që na ofron natyra”, të cilat njerëzit i përdorin dhe varen nga to, në vitet 1970, shkencëtarët filluan të përdorin një term të ri - shërbimet e ekosistemit. Ky term përfshin një gamë të gjerë shërbimesh që ne marrim nga natyra pa asnjë kosto- duke filluar nga luleshtrydhet, burimet ujore, filtrimi i ajrit, rregullimi i klimës globale, formacionet e tokës deri në relievet e mahnitshme të cilat janë frymëzim për artistët.

Pjalnimi, transferimi i polenit nga një bimë tek një tjetër, është një ndër shërbimet e ekosistemit më të rëndësishme, pasi kjo bën të mundur riprodhimin e bimëve dhe ekzistencën e bimëve me lule. Përpos faktit që shumë bimë me lule (sidomos ato të kultivuarat) janë ushqim për njerëzit dhe organizmat e tjera, ato janë gjithashtu pjesë e rëndësishme e të gjithë ekosistemeve, duke filluar me shumë zinxhire ushqimore të cilat, më pas, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe mbijetesën e gjithë gjallesave në planetin tonë. Shumë organizma janë pjalmues, por bletët janë pa dyshim, më kryesoret ndër to. Ky rol i bletëve është më i rëndësishëm se fakti që disa lloje bletësh prodhojnë mjaltë.

Studimet e shkencëtarëve pa mëdyshje tregojnë se bletët janë të rrezikuara, dhe presioni më i madh që ato kanë janë shkatërrimi i habitateve, fragmentimi i tyre, ndryshimet klimatike, parazitët, patogjenët, si dhe praktikat intensive bujqësore të fokusuara kryesisht në monokultura. Efektet e këtyre faktorëve negativë vëzhgohen më lehtë tek bletët që bëjnë mjaltë, pasi këto lloje jetojnë në koloni të mëdha, nëpër koshere dhe nën syrin vigjilent të bletërritësve. Megjithatë, ne nuk duhet të injorojmë faktin që këto faktorë negativë ndikojnë gjithashtu edhe tek mijëra lloje të tjera bletësh që jetojnë të fshehura.

Është përgjegjësia jonë të ndihmojmë shkencëtarët që të shpëtojnë bletët dhe habitatet e tyre. Hapi i parë drejt këtij qëllimi është të njohim më mirë bletët, ciklin e tyre të jetës, ku dhe si ato jetojnë dhe për çfarë kanë nevojë. Bleta e mjaltit është një përfaqësuese e rëndësishme e këtij grupi insektesh, por jo më e rëndësishmja. Rreth një mijë lloje bletësh jetojnë në Ballkan, dhe bleta e mjaltit është njëra prej tyre. Jetët e llojeve të tjera në natyrë janë të ndryshme nga jeta në një koshere. Kjo është arsyeja përse ne duhet të njihemi me pasurinë e botës së bletëve dhe të veprojmë për ti ndihmuar ato.

Udhëzuesi “Bletët – Janë më shumë se Mjaltë” është hartuar brenda projektit “Zonat e Mbrojtura për Natyrën dhe Njerëzit II” dhe është implementuar nga WWF Adria që prej 2019. Ai vjen si rezultat i bashkëpunimit me Jovana Bila Dubaić, një kërkuese shkencore në Universitetin e Beogradit, Fakulteti i Biologjisë. Ky udhëzues është menduar të publikohet për të gjithë trajnerët që merren me edukimin e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, rreth këtyre krijesave të domosdoshme, të zellshme dhe të rëndësishme në planetin tonë. Udhëzuesi do t’ju ndihmojë të mësoni më tepër rreth bletëve, të nisni diskutime, tu përgjigjeni pyetjeve që bëhen më shpesh, dhe të thyeni shumë paragjykime dhe keqkuptime rreth bletëve. Këtu do të gjeni disa sugjerime praktike, se si të ndihmojmë një numër të madh llojesh të ndryshme bletësh. Shtojca 1 përmban disa fletë pune të përshtatshme për grupmosha të ndryshme, e cila do t’ju ndihmojë të testoni njohuritë e marra, ndërsa Shtojca 2 ju jep udhëzime për të mbajtur seminare, me anë të të cilave, së bashku me nxënësit tuaj të mund të bëni diçka të dobishme për bletët.

Ju urojmë një udhëtim të këndshëm në botën e bletëve!

Jovana Dragić May
WWF Adria Programi i Edukimit

PJALMIMI

Duke qenë organizma që nuk mund të lëvizin, bimët kanë nevojë të ndihmohen për tu riprodhuar dhe për të prodhuar fara, e cila është pjesa më e rëndësishme për mbijetesën e çdo lloji. Në mënyrë që disa lloje bimësh të prodhojnë fara dhe fruta, poleni duhet të transferohet nga pjal-morja (pjesa mashkullore e lules), tek kreza (pjesa femërore) e një luleje tjetër. Ky proces quhet pjal-mim. Shumë lloje bimësh varen nga ndihma e kafshëve për të transferuar polenin. Këto kafshë quhen pjalmuese. Pjalmimi i bërë nga bletët, fluturat e natës, lakuriqët e natës, fluturat, mizat, dhe brumbujt sigurojnë mbijetesën e mijëra lloje bimësh, rrjedhimisht të shumë lloje kafshësh, duke përfshirë edhe njerëzit.

Lulet dhe pjalmuesit e tyre janë ndonjëherë të lidhur ngushtë dhe varen nga njëri-tjetri. Për shem-bull, disa lule mund të pllenohen vetëm nga disa lloje të caktuara (ose një numër i kufizuar), ndër-kohë që lulet e tjera tërheqin pllenues të ndryshëm. Forma e një luleje na tregon më shumë rreth pllenuesve të saj. Lulet e hapura janë të përshtatshme për të gjithë llojet, ndërsa lulet e ngushta dhe të gjata tubulare janë të aksesueshme vetëm për fluturat, fluturat e natës dhe bletët *Bombus* pasi ato kanë aparat thithës të gjatë që i lejon të tërheqin nektarin në fund të lules.

Ndër të gjithë pllenuesit, bletët janë më të rëndësishmet. Shkencëtarët vlerësojnë që ne duhet të falënderojmë bletët, për çdo tre kafshata ushqimi që konsumojmë. Tingëllon e pabesueshme, por pa bletët ne duhet të themi lamtumirë disa ushqimeve, si luleshtrydhet, bajamet, qershitë, dardhat dhe domatet. Megjithatë mendimi më i përhapur është se mjalti është përfitimi më i madh ekono-mik që ne marrim nga bletët, në fakt kjo nuk është aspak e vërtetë. Vlera e tyre më e madhe është pjalmimi i bimëve. Prandaj, herën tjetër kur dikush do t'ju pyesë se cili është roli i llojeve të bletëve që nuk prodhojnë mjaltë, ju e dini përgjigjen!

Me pak fjalë, pjalmuesit/pllenuesit ndihmojnë bimët të prodhojnë fruta dhe fara duke transferuar polenin nga një lule në një tjetër. Në shkëmbim, lulet ju japin pllenuesve polen dhe nektar, dhe si rezultat, ne njerëzit shijojmë një shumëllojshmëri të madhe frutash dhe perimesh. Dhe ky është një shërbim fantastik që natyra na ofron, apo jo?

BLETËT

Cilat janë bletët?

Kur mendojmë për bletët, mendja na shkon në një lloj blete perëndimore të mjaltit (*Apis mellifera*). Por ajo çka mund të surprizojë shumicën e njerëzve është fakti që ka mbi 20,000 lloje të ndryshme bletësh. Vlerësohet se të paktën 1,000 lloje bletësh jetojnë në rajonin tonë, në Ballkan. Disa nga ato janë shumë të vogla (vetëm 5-8 mm të gjata), ndërsa disa të tjera shkojnë deri në 2 cm të gjatësi (psh, bleta *Bombus* dhe bletët marangoze).

Bletët bëjnë pjesë në rendin e insekteve të quajtur Himenoptera. Përveç bletëve, edhe milingonat dhe grerëzat i përkasin gjithashtu këtij rendi. Mendohet se bletët, milingonat dhe grerëzat janë insekte me prejardhje të ngjashme, por secila nga këto nëngrupe ka karakteristikat e veta që i bën unike.



NE JEMI BLETËT

Në Ballkan jetojnë rreth 1000 lloje bletësh!

A e dini se ka mbi 20,000 lloje të ndryshme bletësh në botë? Ju ndoshta jeni më të njohur me ato që përdoren për prodhimin e mjaltit. Këto janë bletët e gjinisë *Apis* dhe ka vetëm 7 lloje të tyre.

Ndonëse mjalti është gjëja e parë që ju vjen në mendje kur mendoni për bletët, roli më i rëndësishëm i këtij grupi të madh insektesh është PJALMIMI i bimëve përreth nesh.

Njihuni me disa nga bletët "më të zëna" të Ballkanit.



Anthidium sp.

Bletët "gërvishtëse" gërvishin sipërfaqen e bimëve me push dhe marrin materialin e tyre që ta përdorin për foletë.



Eucera sp.

një bletë me brirë të gjatë

Meshkujt e gjinisë *Eucera* kanë antena shumë të gjata, të cilat i bëjnë ata lehtësisht të dallueshëm.



Halictus sp.

Bletët e familjes Halictidae

Disa bletë janë shumë të vogla, vetëm disa mm të gjata. Bletë të tilla pjallojnë lule të vogla ku bletët më të mëdha nuk mund të hyjnë.



Andrena sp.

Unë jam një bletë gërmuese. Unë gërmoj tunele në tokë dhe i bëj foletë e mia nën tokë.



Stelis sp.

I lëshoj vezët në foletë e insekteve të tjera. Prandaj më quajnë "bletë qyqe". Ka shumë lloje bletësh që jetojnë në këtë mënyrë.



Apis mellifera

Unë jam një bletë mjalti, më e njohura nga të gjitha.



Megachile sp.

Ne quhemi bletë "gjetheprerëse" sepse mund të presim gjethe në dizajnet më të bukura për foletë ku vendosim vezë.




Xylocopa sp.
bletët marangoz

Unë jam bleta më e madhe në Evropë. Mund të jem rreth 3 cm e gjatë! Shikoni krahët e mi, ata po reflektojnë ngjyrë vjollce.

Si duken bletët? Si ti dallojmë ato nga insektet e tjerë të ngjashëm?

Një trup blete përbëhet nga tre pjesë kryesore: koka, kraharoni dhe barku. Këmbët dhe krahët janë të ngjitura me kraharonin. Bletët kanë gjashtë këmbë, nga tre në secilën anë të trupit. Gjithashtu, kanë katër krahë, nga dy në secilën anë të trupit. Ato kanë 5 sy në kokë, dy më të mëdhenj dhe tre më të vegjël. Dy sytë e mëdhenj dallohen lehtësisht, ndërsa tre të vegjlit (të quajtur "sy të thjeshtë") mund të duken vetëm nëse shikoni kokën e bletës nga afër. Gjithashtu kanë edhe antena të vendosura në kokë, që janë një organ sensor shumë i rëndësishëm. Ato e ndihmojnë bletën të ndjejnë ngacmimet të ndryshme nga ambienti rrethues si vibrime, aroma, substanca kimike, madje edhe fushat elektrike.



Pjesët e trupit të bletës

BLETËT

Rendi: *Himenoptera*

● ANTENA TË GJATA

● SYTË MË TË VEGJËL
SE ATO TË MIZËS

● TRUP ME QIME

VETËM LLOJET PARAZITARE

KANË TRUP PA QIME

● FEMRAT KANË GJEMBA

● "BEL" I DALLUESHËM

dy çifte
krahësh
(4 krahë)



barngrënës

— *ushqehen me pjalmin dhe nektarin e luleve*

Trupi i bletëve (përveç disa llojeve parazitare) është i mbuluar me "qime"; ato kanë antena të gjata dhe dy çifte krahësh në secilën anë të trupit (katër krahë në total). Ato kanë një ngushtim që dallohet ndërmjet krahërorit dhe barkut (beli). Të gjitha bletët femra kanë një thumb (gjemb). Bletët janë barngrënëse, pra, ato konsumojnë vetëm ushqim me origjinë bimore - nektar dhe polen.

GRERËZAT

Rendi: *Himenoptera*

- ANTENA TË GJATA
- SYTË MË TË VEGJËL SE ATO TË MIZËS
- TRUP I LËMUAR, PA QIME
- FEMRAT KANË GJEMBA
- "BEL" I DALLUESHËM

dy çifte
krahësh
(4 krahë)



***grabitqarë,
gjithçkangrënës***

trup me ngjyrë të verdhë dhe të zezë

***i referohet llojeve të grerëzave
të gjinive më të zakonshme
(Vespa, Vespula, Polistes)***

Nëse ne krahasojmë bletët me grerëzat, mund të gjejmë shumë ngjashmëri pasi të dyja i përkasin të njëjtit rend insektesh, kanë antena të njëjta dhe numër të njëjtë krahësh, dhe që të dyja kanë ngushtimin e dallueshëm, "belin" ndërmjet krahërorit dhe barkut. Sidoqoftë, ka ndryshime domethënëse ndërmjet tyre, dhe më e dukshme është numri i ndryshëm i qimeve në trupin e tyre. Trupi i grerëzave është i lëmuar dhe me shkëlqim, dukshëm më pak qime. Ndryshe nga bletët, grerëzat janë gjithçkangrënës.

MIZAT

Rendi: *Diptera*

- ANTENA TË SHKURTRA
- SY TË MËDHENJ
- TRUP ME MË PAK QIME SE TË BLETËVE
- PA GJEMBA
- PA BEL

*vetëm një
çift krahësh
(2 krahë)*



gjithçkangrënës

***Ka shumë lloje të ndryshme mizash.
Një përmbledhje e shkurtër e
karakteristikave bazë është dhënë këtu
me qëllim krahasimin me bletët.***

Mizat i përkasin insekteve të rendit Diptera. Ato kanë vetëm dy krahë (një në secilën anë të trupit). Trupi i mizave është i mbuluar me qime, por më të shkurtra se të bletëve. Antenat e tyre zakonisht janë shumë të vogla. Ato nuk kanë ngushtim të dukshëm ndërmjet kraharorit dhe barkut sikurse kanë bletët. Ato nuk kanë thumb, dhe janë gjithçkangrënës.

Si jetojnë bletët? A janë gjithë bletët insekte sociale dhe a jetojnë të gjitha në koshere?

Vetëm 10% e të gjithë llojeve të bletëve në botë kanë një lloj organizimi social, dhe vetëm një numër i vogël i tyre jetojnë në koshere (koloni). Pjesa më e madhe e bletëve bëjnë një jetë të vetmuar, që do të thotë se çdo bletë femër ndërton një zgjuar (fole) të veçantë për veten e saj (dhe pasardhësit e saj). Është e rëndësishme të përmendim se ka një gamë të gjerë mënyrash organizimi "të përkohshme", që nga jetesa sociale e deri tek jetesa e vetmuar e bletëve në botë. Këto të fundit janë ashtuquajtur bletë parazitare (kleptoparazitare) të cilat as nuk ndërtojnë zgjoj e as nuk grumbullojnë ushqim për pasardhësit e tyre, por lënë vezë në foletë e bletëve të tjera, pra sjellje e ngjashme me shpendin e qyqes. Ato mund të dallohen ngaqë kanë më pak qime në trupin e tyre, për shkak të kësaj mënyrë jetese (ato nuk grumbullojnë polen, kështu që nuk ju nevojiten qimet). Nëse shikoni një insekt që ngjan si bletë, por nuk ka qime, me shumë mundësi është një bletë kleptoparazite.

BLETËT


Kleptoparazitarët

● NUK GRUMBULLOJNË PJALM PËR PASARDHËSIT E TYRE DHE PËR KËTË ARSYE:

● KANË TRUP ME PAK QIME

● LËNË VEZËT NË FOLE TË INSEKTEVE TË TJERA

*dy çifte
krahësh
(4 krahë)*




barngrenës

— ushqehen me pjalmin dhe nektarin e luleve, por nuk ruajnë pjalm për pasardhësit e tyre

Si është cikli jetësor i bletëve të vetmuara?

Çdo bletë e vetmuar femër ndërton një zgjua të vogël të veçantë. Procesi i folezimit ndodh si më poshtë: çdo femër gati për të lënë vezë gjen një zgavër të përshtatshme, përgatit një fole, sjell polen dhe nektar, dhe në fund fillon lënien e vezëve. Kur ajo mbush të gjithë hapësirën që ka në dispozicion, mbyll folenë dhe kërkon të gjejë një zgavër tjetër. Shumica e këtyre llojeve nuk kanë kujdes prindëror për pasardhësit e tyre. Procesi i zhvillimit të vezëve ndodh në disa etapa apo faza (veza, larva, prepupa dhe pupa). Larva konsumon ushqimin që ka lënë bleta mëmë, dhe më pas hyn në letargji, një periudhë inaktiviteti (pupa), një stad i cili zakonisht ndodh në dimër, pastaj largohet nga zgjoi si një bletë e rritur në pranverë, dhe cikli fillon nga fillimi.

CIKLI JETËSOR I BLETËS



Ku i ndërtojnë zgjojet bletët?

Bletët e vetmuara kanë një mënyrë jetese shumë unike, kjo e bën zgjojen e tyre shumë të vështirë për tu dalluar. Për këtë arsye shumica e njerëzve nuk e kanë idenë që ato janë kudo rreth nesh. Në krahasim me bletët e vetmuara, ato sociale bien shumë në sy, bletët e rritura gumëzhijnë gjatë aktivitetit dhe janë gjithmonë gati të mbrojnë koloninë e tyre. Ndërsa bletëve të vetmuara ju mungon instikti për të mbrojtur foletë e tyre, dhe ato do t'ju thumbojnë vetëm nëse provoni ti kapni apo ti shtypni (gjë të cilën është e vështirë ta bëni edhe nëse e provoni).



Kolonia e bletëve të egra të mjaltit

Bletët e mjaltit banojnë në zgavra të ndryshme në natyrë, por ato preferojnë më shumë trungjet e pemëve. Nëse dështojnë të gjejnë një zgavër të përshtashme, ato ndërtojnë një koshere mjalti të ekspozuar, në një degë peme. Ky zgjuar i bletës së mjaltit është tamam siç e kemi parë zakonisht nëpër

filma vizatimorë. Në realitet, një koloni që jeton në një koshere mjalti të ekspozuar ndaj bimësisë dhe të ftohtit, zakonisht nuk mund ti mbijetojë dimrit. Në zonat tropikale, situata është ndryshe; bletët shpesh bëjnë koshere mjalti të jashtme, pasi ato nuk kanë nevojë të shqetësohen për temperaturat në dimër.



Hojet e mjaltit të ekspozuara në mjedisin e jashtëm

Shumica e bletëve jo të gjinisë Apis ndërtojnë hoje (zgavra të vogla), të cilat janë të vështira për tu dalluar dhe kjo është arsyeja se pse shpesh herë kalojnë pa u vënë re. Ku janë të vendosura këto zgjoj? Pjesa më e madhe e zgjojeve të këtyre bletëve janë nëntokë (ato gërmojnë tunele në nënsh-tresa të ndryshme toke). Këto bletë quhen **bletë gërmuese**. Ka lloje që banojnë në zgavra të tjera psh. në vrimat e kërcellit të bimëve ose në zgavrat e pemëve të thara. Në varësi të materialit që ato përdorin për të izoluar zgavrat (që janë dhomat e folesë), bletët quhen **ndërtuese** (nëse përdorin baltë), ose bletë **gjetheprerëse** (nëse përdorin gjethet). Disa lloje janë të afta të gërmojnë tunele edhe në pemë të vdekura (ato zakonisht quhen **bletë marangoze**). Disa ndërtojnë zgjoj të jashtme, gjejnë një gropë dhe ndërtojnë folenë e tyre në të. Këto fole duhet të jenë shumë rezistente dhe të qëndrueshme pasi janë të ekspozuara në mënyrë direkte ndaj faktorëve mjedisorë.

KU E BËJNË FOLENË BLETËT?

NË ZGAVRAT E PEMËVE

MES TULLAVE TË NJË MURI TË SHEMBUR

NË NJË GUACKË BOSHE KËRMILLI

NË TUNELET E KRIJUARA NGA
INSEKTET E TJERA NË PEMË

ATA GËRMOJNË TUNELE NË TOKË RANORE

NË KËRCEJTË E BIMËVE
(BAMBU, KALLAMISHTË)

ATA GËRMOJNË TUNELE NË TOKË

ATA GËRMOJNË TUNELE NË TOKË

ATA GËRMOJNË TUNELE NË TOKË

ATA KRIJOJNË TUNELE NË NJË PEMË TË KALBUR

Pse nuk mjafton të mbështetemi vetëm tek bletët e mjaltit?

Bletët e mjaltit kanë avantazhet e tyre kur bëhet fjalë për pllenimin. Ky lloj është aktiv gjatë gjithë sezonit të vegjetacionit dhe viziton një gamë të gjerë bimësh; popullsia e tyre mund të shtohet nga njerëzit dhe kosheret e bletëve mund të tranferohen lehtësisht në vendet ku pllenimi në masë është i nevojshëm. Gjithsesi, bletët e mjaltit, nuk vizitojnë të gjitha bimët, tek ato që vizitojnë, shpesh zgjedhin pjesë bimësh, nga të cilat nuk arrihet pllenimi i ushqimeve që njerëzit mund të konsumojnë. Ka edhe bimë që bletët i shmangin (si psh. dardhat) dhe bimë të cilat nuk i pllenojnë në mënyrë efikase. Nëse flasim në përgjithësi, lloje të ndryshme bletësh pllenojnë bimë të ndryshme. Për më tepër, në rastin e disa bimëve që prodhojnë fruta agregate (këto fruta zhvillohen nga vezore të shumta të së njëjtës lule si: luleshtrydhet dhe mjedra), bletët më të vogla dhe më të mëdha vizitojnë pjesë të ndryshme të një dege me lule; kjo është nevojshme për një prodhim sa më të mirë dhe të plotë të frutave. Me pak fjalë, është e nevojshme të kemi lloje të ndryshëm agentësh pllenimi, në mënyrë që procesi të jetë i plotë dhe përfundimtar. Gjithashtu, gjatë motit të ftohtë, sidomos në pranverë bletët e mjaltit nuk janë mjaftueshëm aktive, ndërsa disa lloje të tjera (sidomos bletët e gjinisë *Bombus* dhe bletët e vreshtit) janë.

Duhet thënë që ne nuk duhet të mendojmë vetëm për bimët që njerëzit përdorin si ushqim, por për të gjitha në tërësi. Shumë bimë me lule të cilat janë rreth e rrotull nesh kanë nevojë për ndihmë për tu pllenuar. Prandaj, jo vetëm prodhimi i ushqimit, por gjithashtu edhe stabiliteti i ekosistemit tokësor varet nga ekzistenca e llojeve të ndryshme të bletëve (dhe shumë pllenuesve të tjerë).

Cilët janë faktorët që ndikojnë negativisht tek bletët?

Globalisht, është dokumentuar se ka një trend rënës të diversitetit dhe numrit të bletëve të gjinive të tjera, jo *Apis*. Një gamë e gjerë faktorësh antropogjen, në mbarë botën, po ndikojnë tek bletët. Studime të shumta në dy dekadat e fundit janë fokusuar në faktorët vendimtarë që kanë influencë më të madhe:

- 1. Fragmentimi dhe shkatërrimi i habitateve të favorshme për bletët**
- 2. Ndryshimet klimatike**
- 3. Bujqësia intensive (monokultura ne hapësira të mëdha gjeografike)**
- 4. Mbipërdorimi i pesticideve, dhe**
- 5. Llojet invazive, patogjenët dhe parazitët.**

Nuk duhen harruar efektet e këtyre faktorëve agravues, që zakonisht janë të kombinuar në mënyrë sinergjike, duke plotësuar dhe ndryshuar njëri-tjetrin, si dhe shtuar kompleksitetin e problemit. Efekti dëmtues i një faktori mund të rrisë efektin e një tjetri, dhe bletët e dobësuara nga njëri faktor bëhen më të ndjeshme ndaj faktorëve dëmtues të tjerë në mjedisin e tyre.

Fragmentimi i habitatit dhe shkatërrimi

Aktivitete të ndryshme njerëzore (si dhe zgjerimi i hapësiravë bujqësore dhe urbane) shkatërrojnë habitatet natyrore, duke i bërë të mos jenë më të ndërlihdura, por më të vogla dhe më të izoluar (të ndara në pjesë më të vogla, fragmente). Ky proces është quajtur fragmentim habitatit. Habitatet e favorshme për botën e gjallë po bëhen jo vetëm gjithnjë e më të vogla, por edhe më të izoluar nga njëri-tjetri. Kjo dëmton veçanërisht organizmat që e vegjël apo ato me lëvizshmëri të ulët, pasi fragmentimi i izolon dhe kufizon në hapësira të vogla.

Çfarë shkakton fragmentimi tek bletët?

Është provuar se llojet më të mëdha të bletëve janë në gjendje të fluturojnë në distanca më të mëdha në kërkim të ushqimit, sesa llojet më të vogla. Gjithsesi është e rëndësishme të përmendim që kapërcimi i distancave të mëdha kërkon kohë dhe energji. Bletët që udhetojnë më larg për të gjetur ushqim (apo për të kërkuar materiale për zgjoit) lëshojnë mesatarisht më pak vezë se sa bletët që kanë burimin e ushqimit më afër zgjoit të tyre. Fragmentimi i habitateve dhe distanca mes zgjoit dhe burimeve të tyre ushqimore, përveçse u konsumon energjinë, redukton gjithashtu edhe jetëgjatësinë e bletëve. Largësia e burimeve të ushqimit nga zgjoit, krijon edhe një rrezik potencial për pasardhësit, pasi femra mungon më gjatë në fole, duke e ekspozuar për një kohë më të gjatë ndaj patogjenëve dhe grabitqarëve.

Dukshëm fragmentimi i habitateve është një ndër faktorët më dëmtues që afektojnë bletët, dhe megjithëse lufta për habitatet e bletëve mund të duket e kotë, nuk është ashtu. Përveç përpjekjeve të institucioneve kërkimore dhe partnerëve të tyre për të shpëtuar habitatet e bletëve, edhe individët mund të ndërmarrin një numër të dobishëm veprimesh (për më tepër detaje të këtyre veprimeve, shikoni paragrafin të titulluar “Çfarë mund të bëjmë për të ndihmuar bletët?”). Këto veprime mund të kryhen direkt në vendet që na rrethojnë, në oborrin e shtëpisë, në ballkon, në pragun e dritares apo në oborrin e shkollës. Në mjediset urbane, edhe hapësirat më të vogla të tokës së gjelbëruar, mund të jenë “gurët vendimtarë” që ndërlidhin oazet urbane më të mëdha për bletët. Prandaj, mos u dekurajoni nëse nuk keni një kopësht të madh, çdo lule që mbillni vetë apo me kursantët tuaj mund të bëhet një vendpushim për bletët dhe të jetë pjesë e mozaikut të habitateve të favorshme.

Nëse shohim gjithë horizontin e një vendi apo rajoni, zonat e mbrojtura luajnë një rol kyç në mbrojtjen e natyrës. Kjo është shumë e rëndësishme për të mbajtur zonat e mbrojtura të lidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet “korridoreve ekologjike”. Kjo redukton efektet negative të fragmentimit të natyrës dhe aftëson shumë lloje të lëvizin lehtësisht në kërkim të ushqimit, strehës dhe vendeve të përshtatshme për riprodhim dhe rritjen e pasardhësve.

Ndryshimet klimatike

Kushtet e motit kanë një efekt domethënës në të gjitha gjallesat, duke përfshirë edhe bletët. Për shembull, temperaturat e ulëta ditore, reshjet dhe era e fortë reduktojnë aktivitetin e bletëve. Gjithsesi, ato që afektojnë më shumë janë ndryshimet afat-gjata të kushteve të motit, pra ndryshimi i klimës në disa vende të caktuara.

Fenologjia është studimi që mat kohën e ngjarjeve të ciklit jetësor në organizmat e gjallë. Ajo studion stadi të ndryshme që gjallesat kalojnë, dhe periudhë e vitit kur ndodhin këto stadi. Muaji në të cilin një lule e caktuar do të çelë apo një kafshë do të zgjohet nga gjumi letargjik, varet nga zona klimatike (psh. parametrat klimatikë) ku organizmi jeton. Prandaj ndryshimet klimatike mund të influencojnë shumë fenologjinë e botës së gjallë.

Disa lloje janë më pak të ndjeshme ndaj këtyre ndryshimeve, ndërkohë që të tjera mund të shfaqin devijim të dukshëm nga “orari” i tyre i caktuar i stadeve të zhvillimit dhe aktiviteteve. Këto devijime nga reagimet e zakonshme, mund të shkaktojnë jopërshtatshmëri ndërmjet fenologjisë së bimëve dhe pllenuesve të tyre. Thënë thjesht mund të shkaktojë një mospërputhje ndërmjet periudhës së lulëzimit dhe aktivitetit të bletëve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet e bimëve shumë të specializuara, të cilat pllenohen vetëm nga lloje të caktuara bletësh.

Për më tepër, ndryshimi i klimës mund të shkaktojë një ndryshim në shpërndarjen gjeografike të disa llojeve, dhe si pasojë, mospërputhje hapësinore ndërmjet bimëve dhe pllenuesve të tyre. Ky nuk është gjithmonë rasti, por duke marrë parasysh se jo gjitha gjallesat reagojnë në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën masë ndaj ndryshimeve në mjedisin e tyre, një skenar i tillë nuk duhet të përjashtohet. Nëse kompleksiteti i komuniteteve që përbëjnë një ekosistem merret parasysh, edhe shkella më e vogël e dukshme e balancës mund të provokojë reaksionin zinxhirin ushqimor, me pasoja që nuk mund t'i parashikojmë lehtësisht.

Duhet të theksojmë që ndryshimet klimatike nuk i referohen vetëm ngrohjes globale, por të gjitha ndryshimeve ekstreme në kushtet e motit (stuhitë, përmytjet, thatësira etj) të cilat me siguri ndikojnë tek popullatat lokale të shumë organizmave, duke përfshirë edhe bletët. Për shembull, përmytjet mund të jenë shkatërruese për të gjithë popullatën, pasi përqindja më e madhe e foleve janë në tokë, ndërsa thatësitë mund të reduktojnë ushqimin e diponueshëm për bletët.

Bujqësia intensive

Aktiviteti bujqësor sa vjen e në rritje, sidomos përhapja e praktikës së kultivimit të një kulture, në hapësira të mëdha toke (dominim monokulture) nënkupton vetëm një gjë për bletët; reduktim i diversitetit ushqimor. Është provuar se ushqimi i njëjtë ndikon në sistemin imunitar të bletëve, duke i bërë ato më të ndjeshme ndaj patogjenëve dhe parazitëve. Bujqësia intensive gjithashtu nënkupton rritjen e përdorimit të pesticideve (për shfarosjen e dëmtuesve të mundshëm të kulturave, të kultivuara) të cilat i ekspozojnë bletët ndaj sasive më të mëdha të substancave kimike (nëpërmjet kontakteve direkte apo indirekte teksa përpiqen të marrin polenin dhe nektarin) që ndikojnë jashtëzakonisht tek ato.



Monokultura

Llojet invazive, patogjenët dhe parazitët

Është e natyrshme që gjallesat të zgjerojnë përhapjen e tyre gjeografike me kalimin e kohës. Nëse ky zgjerim ndodh në mënyrë natyrore, është një proces shumë i ngadaltë, duke i mundësuar përshtatjen ekosistemit dhe organizmave të tjerë të gjallë. Globalizimi, zgjerimi i rrugëve të transportit dhe intensifikimi i tregtisë ndërkombëtare kanë çuar në transferimin (aksidental) të llojeve të ndryshme nga njëra anë e botës në tjetrën. Në këtë mënyrë, me ndihmën e njerëzve, llojet kanë kapërcyer distanca të mëdha, që përndryshe do të ishte e pamundur t'i kalonin. Kjo shkakton një disbalancë në ekosisteme. Të quajtur, lloje alloktone¹ 1 të cilat njerëzit i sjellin në një vend të ri, kanë një potencial të madh të bëhen pushtuese (invazive), që do të thotë se shpërndahen shumë shpejt dhe ndrydhen dhe tkurrin florën dhe faunën vendase. Llojet invazive janë kthyer në një nga shkaqet kryesore të zhdukjes së shumë llojeve. Në rastin e bletëve, rastet e konkurrencës direkte për burime (ushqimi dhe vende për fole) janë raportuar ndërmjet llojeve të bletëve invazive dhe atyre autoktone². Kjo mund të çojë në reduktimin e numrit të bletëve dhe zhdukjen e popullatave lokale.

Patogjenë dhe parazitë të ndryshëm mund të jenë gjithashtu ndër organizmat e transferuar aksidentalisht. Megjithatë patogjenët janë pjesë integrale e jetës së bletëve, nëse një agjenti të ri sëmundjeje shfaqet papritur, mund të jetë shkatërrues. Dihet se evolucioni paralel (bashkë-evolucioni) i një paraziti dhe bujtësit të tij (organizmi ku paraziti strehohet), shkakton zhvillimin e një mekanizmi mbrojtës që mundëson mbijetesën e bujtësit, pavarësisht infektimit nga parazitët, që do të thotë se është vendosur një balancë ndërmjet parazitit dhe bujtësit, me anë të së cilës të dy agjentët që ndërveprojnë do të mbijetojnë (bashkë-ekzistencë). Kur patogjenët/parazitët hyjnë menjëherë në një vend të ri (me ndihmën e njerëzve), infektojnë bujtësit, të cilët nuk kanë zhvilluar akoma mekanizmat mbrojtës të nevojshëm, mund të shkatërrojnë popullatën bujtëse.

Shembulli i një bletë alloktone në Ballkan - bleta e rrëshirës (*Megachile sculpturalis*)

Bleta e rrëshirës (*Megachile sculpturalis*) është me origjinë nga Azia Lindore (Japoni, Kinë, Kore). Ajo fillimisht u regjistrua jashtë shtrirjes së saj gjeografike, në vitin 1994, në Amerikën e Veriut. Që atëherë, ajo u përhap përtej kontinentit. Tashmë është prezente në shumicën e shteteve të pjesës lindore të SHBA-ve, dhe në jug të Kanadasë. Në Evropë, ajo fillimisht u vu re në Francën jugore në 2008. Që atëherë ajo është përhapur shumë shpejt dhe tashmë është prezente në më shumë se dhjetë shtete Evropiane. Në Slloveni, bleta e rrëshirës u regjistrua për herë të parë në vitin 2016. Shumë shpejt ajo u pa në disa vende të Ballkanit (Serbi në vitin 2017, Kroaci në 2019-n, Bosnjë - Hercegovinë në 2020-n).

Si mbërriti ky lloj në Ballkan?

Mendohet që ky lloj udhëtoi nga Amerika drejt Evropës nëpërmjet transportit të mallrave, në të cilin bëri foletë e saj. Këto bletë ndërtojnë zgjoj në zgavra të lëndëve të drusore apo në vrimat e kërcenjve të kallamit dhe bambusë. Cikli i tyre i jetës përfshin një fazë afatgjatë të fjetur, gjatë së cilës mund të transportohet në distanca të mëdha.

Ekologjia dhe sjellja e një blete të skalitur në rrëshirë nuk është studiuar akoma tërësisht, prandaj impakti që mund të ketë, sidomos në faunën vendase të

1 të huaja, lloje që nuk janë vendase

2 lloje vendase

bletëve, nuk është kuptuar plotësisht akoma. Kjo është arsyeja pse është i nevojshëm një kërkim shtesë, në mënyrë që të përcaktohet influenca e këtij lloji në habitatet e tij të reja. Kërkimet shkencore mbi këtë lloj dhe përhapjen e tyre në Ballkan është kryer nga biologë të Qendrës Kërkimore për Bletët dhe Fakultetit të Biologjisë në Beograd.



Bleta e rrëshirës (*Megachile sculpturalis*)

Cilat do të ishin pasojat e zhdukjes së bletëve?

A keni dëgjuar ndonjëherë që Albert Ajnshtajni, një shkencëtar i mrekullueshëm, citohet të ketë thënë: "Nëse bletët zhduken nga toka, njerëzit s'do të kishin më tepër se katër vite jetë"?

Megjithëse Ajnshtajn kishte interes për bletët, ai nuk e ka thënë këtë frazë. Një revistë bletarie ka shkruar pa asnjë bazë këtë thënie si të Ajnshtajnit, në vitin 1940, dhe që atëherë është cituar herë pas here. Edhe pse nuk ka fakte që Ajnshtajni ta ketë thënë këtë fjali, lind pyetja nëse qëndron si fakt apo jo.

Para së gjithash, është e rëndësishme të theksojmë që jo të gjitha bimët riprodhohen me ndihmën e bletëve. Psh, pjesa më e madhe e drithërave pllenohen nga era. Prandaj, njerëzit nuk do të vdesin nga uria nëse bletët shkojnë drejt zhdukjes. Sigurisht jo në një periudhë kaq të shkurtër kohore. Pa dyshim, ushqimi ynë do të jetë më pak i shëndetshëm dhe i ndryshëm (nuk do të kemi kaq shume fruta dhe perime). Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë që ka edhe pllenues të tjerë përveç bletëve. Megjithëse ato mund të jenë më pak efektive sesa bletët, ato sigurisht kontribuojnë në procesin e pllenimit.

Nga njëra anë, zhdukja e bletëve do të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike nga reduktimi i prodhimit dhe sasisë së bimëve bujqësore që varen nga pllenimi. Prandaj, mund të shkaktojë destabilizim të prodhimit të ushqimit dhe ekonomisë, duke i lënë njerëzit pa punë.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të shohim të gjitha copëzat, nëse nuk do kishte më bletë, në ekosistemin natyror do të shfaqej një disbalancë masive, e cila do të influenconte funksionimin e tyre. Bimët me lule mund të mos jenë në gjendje të riprodhohen, dhe këto janë grupi dominant i bimëve në planetin tonë.

Si përfundim, deklarata që njerëzimi do të zhdukej në katër vite nëse bletët do të zhdukeshin, është e ekzagjeruar. Asgjë domethënëse nuk do të ndodhte në katër vite. Gjithsesi, është e rëndësishme të tregojmë kompleksitetin e kësaj çështjeje, duke kujtuar se një ndryshim provokon një gamë të gjerë ndryshimesh të tjera. Qartazi ne nuk mund të parashikojmë plotësisht të gjitha pasojat, gjithsesi bazuar në ato çfarë dimë, mund të deklarojmë që ndryshimet do të ishin thelbësore, dhe do të ndryshonin rrënjësisht mënyrën tonë të jetesës.

Çfarë mund të bëjmë ne për t'i ndihmuar bletët?

Ne mund të rrisim sasinë e ushqimit të bletëve, duke mbjellur bimë miqësore për pllenuesit. Është e rëndësishme të mbjellim sa më shumë llojë bimësh që nuk çelin në të njëjtën kohë, në mënyrë që bletët të kenë ushqim gjatë gjithë vitit. Mësoni më tepër rreth këtyre bimëve të cilat janë të mira për pllenuesit (psh. livandoja, lulemustaku, pema e dëlirë (*Vitex-agnus-castus*), *Lythrum salicaria*, Ligustra, etj).




Livando

Shtimi i sasisë së ushqimit për bletët nuk ka nevojë për shumë kosto, nuk është e nevojshme të blejmë bimë miqësore me pllenuesit. Mjafton të lejojmë që bimët e egra, miqësore me pllenuesit, të formojnë një komunitet bimësh të egra (lëndina që rriten vetvetiu) kudo të jetë e mundur. Bletët e adhurojnë tërfilin e kuq, hithrën e butë, luleradhiqen, bimën e lëpushës, mëllagën, pështrikun, lulemizë mjekësore, jonxhën etj.



Gjembaku – gastia e bletëve



Livadh i larmishëm



Bletët – ushqyerja me bimë të egra

Ne mund të jemi "kopshtarë dembelë" dhe kositim rrallë. Nëse kositim shpesh, heqim ushqimin për bletët dhe pllenuesit e tjerë. Ne duhet të kositim me parcela, dhe jo të gjithë sipërfaqen përnjëherë. Kjo quhet kositje mozaik. Në këtë mënyrë, pllenuesit kanë ushqim të mjaftueshëm, derisa bimësia të rritet në pjesën që kemi kositur në fillim. Nga kjo mënyrë kositje përfitojnë jo vetëm bletët, por edhe organizmat e tjerë.

Ne mund të zbavitemi duke ndërtuar "hotele" për bletët, kështu u sigurojmë vend për të ndërtuar fole. Për udhëzimet e ndërtimit të një hoteli të tillë, shikoni shtojcën nr. 1.

Nëse shihni bletë gjermuese duke ndërtuar folenë e tyre në tokë, përpiquni të mos i gërmoni këto pjesë të kopshtit. Këto bletë nuk dëmtojnë bimët tuaja, ju mund ti vaditni ato si zakonisht, por mos gërmoni në këto hapësira.


Trungjet e pemëve të kalbura nuk duhet të hiqen, lërinie aty ku janë sa më shumë kohë të jetë e mundur. Pemët e thara, e të kalbuara janë vende të rëndësishme për fole, për shumë lloje bletësh marangoze dhe insektesh të tjera. Ato njihen si thesar i biodiversitetit. Edhe nëse një pemë e tharë është në rrezik për rënie, nuk duhet të hiqet. Mjafton të shtrini pemën në tokë, dhe kështu mund të ndihmojë organizma të ndryshëm të vazhdojnë të jenë pjesë e ciklit të jetës së gjallë



Trungjet e pemëve të thara - shtëpi e shumë organizmave

Gjatë vjeshtës dhe dimrit, rekomandohet të mos hiqen gjethet e rëna. Nëse është e mundur të lihen mbi tokë shtresa të trasha të gjetheve të rëna dhe të hiqen vetëm nga rrugët me asfalt. Gjethet e rëna që mblidhen nuk duhet të hidhen në kosha të përgjithshëm, e as nuk duhet të digjen. Gjethet paraqesin një hallkë të rëndësishme në ciklin e jetës së gjallë, dhe në të njëjtën kohë, janë strehë për shumë organizma, duke përfshirë edhe bletët. Organizma të ndryshëm gjejnë strehë dhe vend për të kaluar dimrin në shtresat e gjetheve të rëna.

Ne mund të reduktojmë përdorimin e pesticideve dhe kimikateve të tjera në kopshtet tona (apo në ndonjë hapësirë tjetër të gjelbër). Balanca e vendosur në ekosistemet natyrore, shpesh ndërpritet nga ne, njerëzit. Kjo shkakton riprodhim në masë të disa organizmave (dëmtuesve), të cilat më pas trajtohen me kimikate. Në të njëjtën kohë, kjo na kushton më tepër para dhe kohë. Kohët e fundit, ajo që njihet si "kontrolli biologjik i dëmtuesve" po zbatohet më shumë. Kjo qasje përqipet të "imitojë" sa më mirë kushtet natyrore në mjedisin tonë, në mënyrë që të rikthejmë balancën e duhur për organizmat e gjallë në një vend. Nëse ia dalim mbanë, natyra vazhdon vetë më tej me funksionet e saj. Për shembull, nëse ne krijojmë lëndina të ndryshme në kopshtet tona, nuk do të duhet të merremi me të gjatë gjithë kohës. Aty formohet një lloj ekosistemi i vetë-qëndrueshëm, të cilin mjafton të ulemi dhe ta shijojmë. Nga kushtet brenda hapësirave të vetë-qëndrueshme, do të përfitojnë shumë organizma të ndryshëm, përfshirë edhe grabitqarët edhe parazitët, të cilët mbajnë numrin e organizmave të tjerë (që ne njerëzit i quajmë dëmtues) në nivele të pranueshme.



Luledelet në pranverë

20 FAKTE RRETH BLETËVE

1. BLETA E VOGËL PUNËTORE

- Përafërsisht 80% e bimëve të egra dhe
- 75% e shumicës së kulturave më të
- rëndësishme, varen nga pllenimi nga
- kafshët. Një në çdo tre kafshata të ushqimit që ne konsumojmë varet nga
- pjalmuesit. Është e rëndësishme të
- shtojmë që disa bimë që janë autogame
- apo pllenohen nga era, kanë fruta më të mëdha apo më të shijshëm nëse ato vazhdojnë të pllenohen nga pjalmuesit.

3. NATYRA ËSHTË RICIKLUESI MË I MREKULLUESHËM

A e dini që disa bletë banojnë në guacka kërmilli boshe? Pasi pastrojnë guackën, sjellin ushqim dhe lëshojnë vezë aty . Çdo vezë është në një dhomë më vete brenda guackës. Më në fund ato, izolojnë hyrjen e guackës me një përzierje balte dhe zhavorri, dhe lejojnë të vegjlit e tyre të kalojnë dimrin aty. Vitin e ardhshëm , bletët e rritura, fluturojnë nga guacka dhe përsëritin ciklin nga fillimi. Prandaj, kur shëtitni në natyrë, jini të kujdesshëm se mos shkelni ndonjë guackë kërmilli; mund të jetë një kërmill brenda ose edhe një fole bletësh!

4. RIKTHIM NË JETË



Nëse vini re një bletë që duket sikur po sillet çuditshëm, kjo mund të ndodhë sepse ajo aktualisht po pushon. Gjithsesi nëse akoma mendoni që ajo ka nevojë për ndihmë, ju mund ta shtrini atë butësisht në një bimë mjalti aty pranë. Nëse nuk ka lule të tilla afër jush, përzieni pak sheqer të bardhë dhe ujë në raport 50:50 , i cili do ti jepte bletës energji për të fluturuar. Çojeni atë në një vend të mbrojtur jashtë, ofrojeni disa pika të kësaj përzierje të ëmbël, dhe jepini kohë të marrë veten. Mos e mbani bletën brenda një hapësire të mbyllur. (nuk rekomandohet sheqeri kaf, për shkak se është më i vështirë për tu tretur. Gjithashtu mos i jepni mjaltë pasi mund të përmbajë lëndë patogjene).

2. UNË JETOJ KËTU DHE KJO MË PËLQEN!

Bletët mund të gjenden në vende të ndryshme, por disa nga këto vende të befasojnë. Bletët ndërtojnë foletë e tyre në: habitate moçalore, zhavorr, në dunat e rërës, sedimente, habitate shkurre, habitate të lagështa, livadhe gëlqerore, miniera zhavorri, shkëmbinj deti, zgavrat e trungjeve të pemëve. etj.

5. NJË TRAJTIM JO I ZAKONSHËM - DJERSA E NJERIUT

Disa lloje bletësh u pëlqen të trajtojnë veten me pak djersë nga njeriu. Po, e keni lexuar saktë!

Nëse vini re një bletë që ka ndaluar mbi ju, mos u frikësoni. Vëzhgojeni. Ato nuk janë agresive dhe nuk do t'ju thumbojnë (vetëm nëse e shtyp me dorë). Vëzhgojeni se si goja e saj e hollë del nga nofullat e saj dhe prek lëkurën tuaj. Pse të mos i japësh një trajtim, nuk ju kushton gjë!



6. NJË BLETË NUK KA DY, POR KATËR FLATRA



Bletët kanë nga një flatër më të madhe dhe nga një më të vogël në secilën anë të trupit. Kur fluturojnë, dy flatrat bashkohen së bashku me një grip të vogël pothuaj të padukshëm në cepin e flatrës. Në këtë mënyrë formohet një sipërfaqe më e madhe duke u mundësuar fluturim më të lehtë. Kur bletët ulen mbi një sipërfaqe, flatrat palosen mbi njëra tjetrën.

8. A ËSHTË ÇIFTËZIMI FUNDI I JETËS SË MESHKUJVE?

Vetëm meshkujt e bletëve punëtore vdesin menjëherë pasi çiftëzohen, ndërsa meshkujt e llojeve të tjera mund të çiftëzohen disa herë.

9. GJUMI DIMËROR

Ku e kalojnë bletët dimrin? Kjo varet nga lloji.

Bletët e mjaltit e kalojnë dimrin në zgjoin e bletëve. Bletët punëtore formojnë një rreth rrotull mbretëreshës për ta mbajtur atë ngrohtë gjatë dimrit. Ato nuk dalin jashtë zgjoit në periudhën e dimrit, dhe përveç ngrohjes, nuk ka shumë aktivitete në koloni. Çfarë hanë ato? Epo, ato kanë mjaltin në magazina. Disa bletë e kalojnë dimrin në letargji, të vendosura në një vend të mbrojtur (letargjia apo gjumi i dimrit është një periudhë inaktiviteti gjatë të cilit proceset janë të reduktuara në minimum). Çfarë bëjnë bletët e vetmuara gjatë dimrit? Shumica e llojeve të bletëve të vetmuara nuk jetojnë deri në dimër! Pasi ato çiftëzohen, përgatisin foletë, lëshojnë vezët, dhe sigurojnë ushqim për pasardhësit e tyre. Të gjitha këto bletë të rritura vdesin. Të vegjlit e tyre kalojnë dimrin në stad inaktiv, në struktura brenda foleve të tyre.

10. TË VEGJËL POR TË ZGJUAR



Truri i bletëve *Bombus* është në përmasën e një fare lulëkuqeje. Duke patur këtë në mendje, është mahnitëse se si shkencëtarët ia kanë dalë mbanë të trajnojnë bletët për të shënuar gola në lojën "futbolli i bletëve", duke i shpërblyer me një gosti. Sa bukur tingëllon kjo!

zzz...



7. SHTRATI IM ËSHTË MË I MIRI

Bletët e mjaltit dhe shumica e bletëve e gjinisë *Bombus* shkojnë tek kolonitë e tyre dhe kalojnë natën atje.

Po bletët e tjera çfarë bëjnë? Femrat e shumicës së llojeve kalojnë natën në follenë e tyre, të cilën ato e kanë përgatitur për të vendosur vezët, kurse meshkujt kalojnë natën të mbuluar nga bimësia në lule apo ngjitur në kurorën dhe kërcellin e bimëve. Nëse shikoni nga afër, sidomos herët në mëngjes përpara se të ngrohet moti, mund të jeni me fat t'i shikoni duke fjetur. Kjo është një eksperiencë e veçantë!

11. JO TË GJITHA BLETËT VDESIN PASI THUMBOJNË



Fakti që bletët vdesin pasi thumbojnë është i vërtetë vetëm në rastin e bletëve të mjaltit. Thumbi i tyre është "me dhëmbëza" kështu që ngjitet në lëkurën e personit të thumbuar dhe në momentin që bleta tenton të fluturojë apo të largohet, një pjesë e barkut të saj, del jashtë. Përfundimisht kjo shkakton vdekjen e bletës. Asnjë lloj tjetër bletësh nuk ka një thumb të tillë, dhe mund të thumbojnë disa herë. Për më tepër, meshkujt të çdo lloj tjetër blete nuk kanë thumb, kështu që nuk mund të thumbojnë.

12. DIVAT VALLËTARE



Bletët e mjalit komunikojnë nëpërmjet lëvizjeve të trupit, të cilën ne shpesh e quajmë "kërcimi i bletëve". Në këtë mënyrë, bletët punëtore komunikojnë në mënyrë efektive me njëra-tjetrën rreth vendndodhjes dhe distancës të burimit të ushqimit dhe burimeve të tjera.



14. NGA SE PËRBËHET MJALTI?

Bletët e mjalit mbledhin nektar nga lulet dhe e ruajnë atë në një pjesë të veçantë të barkut të tyre. Aty brenda, nektari përziehet me enzima që prodhohen nga bleta. Në fund kjo përzierje ruhet në dhoma të veçanta brenda kolonisë së bletëve (zgjoit). Duke përplasur krahët e tyre, bletët përshpejtojnë avullimin e ujit të tepërt, gjë e cila çon në trashjen dhe krijimin e mjalit. Prandaj, mjalti është një përzierje unike e bimëve dhe "lëngjeve" të bletës.

13. DARKA MBRETËRORE



Kur mbretëresha e një zgjoit bletësh vdes, bletët punëtore do të "shpallin" një mbretëreshë të re menjëherë. Si "krijohet" mbretëresha e re? Bletët punëtore i japin ushqim special, i quajtur "vakti mbretëror" një larve të përzgjedhur nga ato vetë, të cilën e kthejnë në mbretëreshën e re. Kështu që, një mbretëreshë dhe një bletë punëtore mund të zhvillohen nga e njëjta larvë; gjithçka varet nga ushqimi me të cilin ushqehet!

15. EDHE BLETËT BOMBUS BËJNË MJALTË!

A e dinit që edhe bletët e gjinisë *Bombus* bëjnë mjaltë? Kolonitë e tyre janë vjetore, kështu që ato nuk kanë nevojë të prodhojnë sasi të mëdha rezervash, por ato prodhojnë mjaltë për siguri. Dhe a e dini se ku e mbajnë ato? Mjalti mbahet në dhoma të vogla që ngjajnë si tenxhere të vogla!

16. TI BLETË, SA VJEÇ JE?

Sa gjatë jetojnë bletët? Shumica e bletëve nuk jetojnë gjatë – vetëm disa javë! Ato jetojnë mjaftueshëm sa për tu çiftuar, pëe të bërë folenë dhe për të lëshuar vezët. Gjithsesi, ka lloje të rriturit e të cilëve jetojnë disa muaj (psh. Bletët *Bombus* dhe bletët marangoz), madje mund të jetojnë edhe disa vite (psh. Mbretëresha e zgjoit të bletëve).

Prandaj, përgjigja e kësaj pyetje nuk është e thjeshtë, ashtu sikurse edhe bletët nuk janë.

17. BLETËT "QYQE"

Duhet të keni dëgjuar për shpendin e qyqes i cili i lëshon vezët në foletë e shpendëve të tjerë? Mund t'ju surprizojë fakti që një sjellje e tillë ekziston edhe në botën e bletëve! Bletët që lëshojnë vezët në foletë e bletëve të tjera quhen parazitare, apo më saktësisht, bletë kleptoparazitare. Pasi hyn fshehurazi në folenë e një lloji tjetër bletësh, një kleptoparazitar femër lëshon vezët dhe largohet. Çfarë ndodh më pas? Larva e saj ha të gjithë ushqimin në fole, pasi ato zhvillohen më shpejt se sa larvat e bletëve që ishin fillimisht në fole (larva bujtëse), dhe nuk ka shans të mbijetojë. Sado mizore të duket, mos u inatosni me bletët kleptoparazitare. Kjo është natyra.



18. A NDIHMOM KULTIVIMI I BLETËVE TË MJALTIT DIVERSITETIN BIOLOGJIK?

Është e gabuar të besosh që ne mund të ndihmojmë bletët nëse bëhemi bletërritës. Bletërritja nuk është edhe aq e thjeshtë dhe kërkon shumë përgjegjësi. Është vërtetuar që kur shumë koshere bletësh janë instaluar në një vend, bletët e mjaltit mund të konkurrojnë me bletë të tjera të egra për burimet ushqimore dhe mund të transferojnë patogjenët dhe parazitët tek to. Duke vendosur shumë kosherenë një vend, ne ushtrojmë presion shtesë tek llojet e bletëve të egra që janë tashmë të rrezikuara, duke u shkaktuar atyre dëme në diversitetin biologjik.

Është e rëndësishme të themi që bletët e mjaltit, si lloje të menaxhuara, janë të vetmet lloje bletësh që nuk janë në rrezik zhdukjeje. Njerëzit i ndihmojnë ato në mënyra të ndryshme, i ushqejnë, i kurojnë, dhe i vendosin ato në habitate të ndryshme. Për më tepër ato mund të riprodhohen në mënyrë artificiale. Numri i bletëve në botë në ditët e sotme është më i lartë se kurrë më parë.

Prandaj, nëse ne duam ti ndihmojmë bletët, të gjitha bletët, dhe të inkurajojmë biodiversitetin, ka shumë veprime që ne mund të bëjmë, por bletërritja nuk është nga këto.

19. BLETËT SI KOPSHTARË DEMBELË!

Secili nga ne mund të bëjë diçka për ti ndihmuar bletët. Për shembull, ne mund të rregullojmë kopshtet tona apo ballkonet në mënyrë të tillë që bletëve tu sigurohet ushqimi dhe vendet e folezimit. Një sasi e madhe e ushqimit të bletëve nuk ka kosto të madhe për ne. Nuk është e nevojshme të blini bimë miqësore me pllenuesit. Mjafton të rritni disa nga bimët e vetë pllenueshme, që bletët duan fort. (psh: luleradhiqe, hithër të butë, jonxhë, tërfil të kuq e të bardhë). Gjithashtu, lëndinat duhet ti kositim me radhë, njëherë një parcelë, pastaj një tjetër, dhe jo përnjëherësh. Kjo quhet kositje mozaik. Në këtë mënyrë bletët do të kenë ushqim për të ngrënë derisa bimësia të rritet përsëri në parcelën që u kosit e para. Nga kjo mënyrë e mirëmbajtjes së lëndinave, përfitojnë edhe organizmat e tjerë të dobishëm, jo vetëm bletët.

Kështu që, mjafton të kaloni më tepër kohë në kopshtin tuaj duke pushuar, sesa duke provuar ta mbani të pastër. Bletët do t'u ishin mirënjohëse për këtë!

20. EDHE BLETËT KANË RRJET TRAFIKU

Imagjinoni sikur duhet të udhëtoni në një vend të largët, por nuk ka rrugë që ta bëjë udhëtimin më të lehtë për ju. Pikërisht kështu ndihen bletët në ditët e sotme. Habitatet e tyre natyrore kanë ndryshuar shumë ose janë shkatërruar plotësisht nga njerëzit. Dihet që bletët, sidomos ato më të voglat, nuk mund të udhëtojnë në distanca të gjata pa pushim dhe pa ushqim. Kjo është arsyeja përse habitatet e ndërlidhëse janë shumë të rëndësishme, ato u mundësojnë bletëve (dhe insekteve të tjera) të lëvizin në hapësirë dhe të qëndrojnë në lidhje me njëra-tjetrën. Të ashtuquajtura korridore ajrore për bletët, janë një zgjidhje e zgjuar dhe kreative, në vendet ku habitatet janë shkatërruar apo fragmentuar. Aktualisht, këto janë "rrugët për insektet", të cilat kalojnë mes fshatrave dhe qyteteve, dhe lidhin hapësirat natyrore ekzistuese, duke krijuar një rrjet të habitateve të favorshme.

* Disa nga informacionet e prezantuara këtu janë marrë nga: <https://www.wwf.org.uk/learn/fascinating-facts/bees>

SHTOJCA 1. FLETORË PUNË

Kjo shtojcë përmban disa fletë pune që synojnë grupmosha të ndryshme fëmijësh dhe të rinjsh. Fletët e punës janë konceptuar në mënyrë të tillë që të testojnë njohuritë e kërkuara, duke u argëtuar. Ju mund ti printoni dhe ti përdorni ato në orë mësimore apo seminare.

Udhëzime për fletën e punës:

1. Shkruani pjesët e trupit të bletës

(përgjigjet mund ti gjeni në pjesën kryesore të tekstit të titulluar "Si duken bletët? Si ti dallojmë ato nga insektet e tjera të ngjashme?")

2. Gjeni miza, bletë dhe grerëza

(përgjigja është në fund të këtij udhërrëfyesi)

3. Cikli i jetës së bletëve

(përgjigja mund të gjendet në pjesën kryesore të tekstit të titulluar "Si është cikli jetësor i bletëve të vetmuara?")

4. Vizatoni pjesët e tjera të insektit

(një fletë pune që synon grupmoshën e të rinjve)

SHKRUANI PJESËT E TRUPIT TË BLETËS





Në foto janë 4 miza, 5 bletë dhe
5 grerëza. PROVONI TI GJENI!




Qarkoni mizat
Shënoni bletët ✓
Nënvizoni grerëzat




CIKLI JETËSOR I BLETËS


Shkruani emrat e fazave të zhvillimit të bletës




VIZATONI PJESET E TJERA TË INSEKTIT




VIZATONI PJESET E TJERA TË INSEKTIT




VIZATONI PJESET E TJERA TË INSEKTIT




VIZATONI PJESET E TJERA TË INSEKTIT



VIZATONI PJESET E TJERA TË INSEKTIT



VIZATONI PJESET E TJERA TË INSEKTIT



SHTOJCA 2. SEMINAR SE SI TË NDËRTOHEN “HOTELE” PËR BLETËT

Objekti: Të mësojnë rreth mënyrave të ndryshme të jetesës së bletëve dhe llojet e foleve që ato ndërtojnë; të rrisim ndërgjegjësimin e ekzistencës së llojeve të tjera të bletëve përveç bletëve të mjalit.

Mosha: Nga mosha 5 vjeçare me ndihmën e të rriturve; në mënyrë të pavarur nga mosha 8 vjeçare; një aktivitet edukativ dhe zbavitës edhe për të rriturit.

Numri i pjesëmarrësve: 5-30; punë në grupe deri në 5 pjesëmarrës, me një të rritur për grup, kur punohet me grupe më të vogla.

Metoda: Pjesëmarrësve u prezantohet një histori e përshtatshme për moshën e tyre. Më pas, ata ndahen në grupe (deri në 5 pjesëmarrës) dhe u jepen materialet dhe mjetet e nevojshme. Pasi hoteli është ndërtuar, është e nevojshme të zgjidhet një vend i përshtatshëm ku do të instalohet.

Materialet: Një poster edukativ me bletët (apo fotografi e bletëve dhe fole të tyre, të printuara apo në një ekran kompjuteri), kallamishte ose dru bambeje, lidhëse plastike për të lidhur kërcenjtë e kallamave, litar ose tel për të siguruar hotelin.

Kohëzgjatja: Nga 60 deri 120 minuta (10 minuta për të treguar historinë; 30 minuta për të ndërtuar hotelin; rreth 30 minuta për të zgjedhur një vend për të siguruar ndërtimin e rreth dhjetë hoteleve (varet nga numri i hoteleve të ndërtuara; rreth 30 minuta për të ndërtuar deri në dhjetë hotele).

Përshtateni aktivitetin me fëmijët me aftësi ndryshe: Fëmijët e verbër ose me shikim të dëmtuar mund të marrin pjesë në këtë aktivitet, me ndihmën e një ndihmësi apo fëmijëve të tjerë në grup. Për fëmijët e shurdhër apo për fëmijët me dëgjim të dëmtuar duhet të angazhohet një përkthyes i gjuhës së shenjave në fillim të seminarit, ndërkohë që ju jepni udhëzimet e ndërtimit të hotelit.

Seminar i përshtatur për moshat 5-8

Pyetje të sugjeruara: Në opinionin tuaj, sa lloje bletësh gjenden në botë?

A keni dëgjuar për bletët e mjalit? Cilat bletë jetojnë në koshere dhe prodhojnë mjaltë? Dhe a e dini që ka shumë lloje të tjera bletësh, të cilat nuk prodhojnë mjaltë? (pas çdo pyetje, prisni që pjesëmarrësit të përgjigjen); ato mund të përgjigjen individualisht duke ngritur dorën ose në grup, nëse konsideroni që nuk ka vullnetarë të përgjigjen në mënyrë të pavarur përpara studentëve të tjerë).

Përgjigja: Të paktën 1,000 lloje bletësh jetojnë vetëm në Ballkan! A mund ta imagjinoni se sa janë? Disa nga ato janë shumë të vogla (tregoni diçka që është 5 mm e gjatë), ndërsa disa të tjera janë më shumë se 2 cm të gjata (psh. Bletët Bombus, bletët marangoz).

Pyetje të sugjeruara: Bletët e mjaltit jetojnë në koshere. Sipas jush, ku jetojnë llojet e tjera të bletëve? Ku i ndërtojnë foletë e tyre?

Shumica e bletëve jetojnë në mënyrë të pavarur. Kjo mënyrë jetese është quajtur solitare apo e vetmuar. Çfarë do të thotë kjo saktësisht? Do të thotë që çdo femër bën një fole të vogël për veten, në të cilën lëshon vezët.

Ku i ndërtojnë ato foletë e tyre? Shumica e bletëve gërmojnë **tunele nëntokësore** dhe bëjnë foletë aty. Disa lloje preferojnë zgavra në formë tuneli (psh. **Zgavra në trungjet e pemëve** apo **tunele të braktisura në pemët e vdekura** të gërmuara nga insektet e tjera). Ka disa lloje bletësh që janë të afta të gërmojnë vetë në trungun e një peme. Në rajonin tonë, ndodhen gjithashtu disa lloje që bëjnë foletë e tyre në **guacka boshe kërmijsh**! Ka gjithashtu nga ato që pëlqejnë zgavrat e mëdha (në tokë, trungjet e pemëve dhe shkëmbinj të).

Nëse ato gërmojnë tunele nën tokë, quhen **bletë gërmuese**. Nëse përdorin zgavra në formë tuneli, ato quhen **bletë ndërtuese**. Nëse shpojnë tunele në pemët e vdekura, ato quhen **bletë marangoz**.

Ndërveprimi i lidhur me ilustrimin: “Ku e ndërtojnë bletët follenë?” (vullnetarët e interesuar mund të bëjnë një hap përpara ekranit (poster); tregojnë lloje të ndryshme të foleve të ilustruara apo lexojnë grupit me zë të lartë rreth foleve/tokës/materialit në fjalë).

Pyetje të sugjeruara: Në opinionin tuaj, si jetojnë shumica e bletëve? A do ishit të interesuar të kuptoni se çfarë ndodh brenda një foleje?

Brenda folesë së saj një bletë femër ndërton dhoma të vogla, një për secilën vezë. Pranë çdo veze të lëshuar, ajo lë një top ushqimi (përzierje e polenit dhe nektarit), dhe më pas, duke përdorur materiale të ndryshme të gjetura në natyrë, ajo e izolon këtë dhomë dhe fillon të përgatisë një tjetër. Pasi e gjithë hapësira në fole është zënë, ajo mbyll follenë dhe niset të gjejë një zgavër të re. Llojet e vetmuara të bletëve nuk do të mbrojnë follenë e tyre, por as nuk do t’ju sulmojnë. Ato mund të pickojnë, por vetëm nëse doni ti kapni apo ti shtypni. Kështu që ndihuni të lirë ti vëzhgoni, por mos i prekni!

Pyetje të sugjeruara: Ku janë meshkujt e kosheres ndërkohë? Çfarë bëjnë ata, si jetojnë?

Meshkujt kanë vetëm një përgjegjësi, të çiftohen me femrat. Pas çiftimit, femrat gjejnë një vend për fole, e përgatisin atë dhe sjellin ushqim. Meshkujt nuk marrin pjesë në këto aktivitete.

Besohet gjithashtu që meshkujt nuk marrin pjesë në pjalmim, për shkak se nuk mbledhin ushqim, polen, për pasardhësit e tyre. Gjithsesi meshkujt vizitojnë lulet, për nevojat e tyre ushqimore, dhe kështu bëhen pjesë e pjalmimit.

Udhëzimet për të ndërtuar një hotel bletësh:

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla. Çdo grup duhet të ketë një të rritur dhe 3-5 fëmijë (varet nga mosha). Zgjidhni 15-20 kërcej kallami, por bëni kujdes që zgavrat të kenë diametër të ndryshëm (përmasa). Zgjidhni disa kërcej më të vegjël, disa në përmasë mesatare, dhe disa në përmasë më të madhe (pra nga më të hollët deri tek më të trashët). Kjo siguron që bletët e vogla dhe të mëdha së bashku do të vijnë në hotelin tuaj (bletët e vogla do të qëndrojnë në tunele më të vogla, ndërkohë që bletët më të mëdha do të zgjedhin tunelet me diametër më të madh).



Sigurohuni që çdo kallam ka një "mur të pasëm"; tunelet nuk duhet të kenë hapje në të dyja anët fundore, që do të thotë, nëse shikoni nëpërmjet zgavrës, duhet të jetë e mbyllur nga ana tjetër fundore. Angazhoni fëmijët të kontrollojnë mes zgavrave të kallamit për tu siguruar që fundi i tyre të jetë i mbyllur; nëse jo, atëherë kallami nuk është i përshtatshëm për të bërë hotelin. Madje edhe nëse ju nuk keni llojin e duhur të kërcellit të kallamit, mund të përdorni disa materiale për ti bërë ato të përdorshme. Përdorni baltë për të izoluar njërin anë, nëse kërcelli i kallamit është i hapur në të dy anët.



Rendisni së bashku ato dhe lidhini me një lidhëse plastike. Nëse lidhëset janë shumë të shkurtra, përdorni 2 ose më shumë lidhëse të bashkuara. Shtrëngojini fort ato.

Tashmë, hoteli është gati për tu ndërtuar. Ju duhet të zgjidhni një vend për ta ndërtuar dhe sigurojeni atë me një tel apo litar.



Si të gjeni një vend të përshtatshëm për hotelin e bletëve?

Një hotel nuk duhet të instalohet në tokë për shkak të lagështirës së lartë. Optimajla është që të instalohet të paktën një metër sipër tokës. Është e rëndësishme të instalohet në një vend ku të jetë i qëndrueshëm dhe të mos t'ju shqetësojë juve, por ama mjaftueshëm afër sa të vëzhgoni aktivitetet rreth tij.

Zgjidhni një vend të strehuar nga shiu dhe dëbora (apo ndërtoni një çati të vogël), por përsëri jo me shumë hije pasi bletët e duan diellin. Gjithsesi, përpiquni të mos gjeni një vend të ekspozuar në diell gjatë gjithë ditës.



Sapo ta keni instaluar, mos e lëvizni atë. Mos e fusni brenda gjatë dimrit, pasi kjo mund të konfuzojë bletët, duke i bërë të mendojnë që ka ardhur pranvera ose vera. Kjo mund të shkaktojë zgjim nga gjumi letargjik para kohe gjithashtu.

Cila është koha optimale e vitit për të instaluar një hotel bletësh?

Një hotel bletësh mund të vendoset në çdo kohë të vitit. Gjithsesi periodha më e mirë është në fillim pranvere (kështu do të jetë gati edhe për bletët e pranverës edhe ato të verës).

A është e nevojshme të pastrosh një hotel bletësh apo të kujdesesh gjithmonë për të?

Sapo ta keni vendosur hotelin e bletëve, nuk do të keni më përgjegjësi. Nëse bletët bëjnë aty foletë (zgjojtë) e tyre gjatë pranverës dhe verës, thjesht shijojini duke i parë ato të punojnë fort. Pasi përfundojnë zgjoin, ato izolojnë hyrjen me materiale të ndryshme të gjetura në natyrë (kryesisht baltë dhe rrëshirë). Vitin e ardhshëm, bletët e rritura do të fluturojnë nga aty. Bletë të reja femra, që dëshirojnë të bëjnë përsëri aty foletë e tyre, do të pastrojnë tunelet vetë dhe do ti përgatisin ato.



Prandaj, ju nuk keni nevojë të pastroni hotelin, ta fusni brenda apo të kujdeseni për të në mënyra të tjera.

Nëse vini re tufa shpendësh rreth hotelit, rekomandohet të vendosni një rrjetë në një lartësi të caktuar sipër hotelit. Në këtë mënyrë, ju do të parandaloni shpendët që të ushqehen me larvat brenda zgjoit.

Gjithashtu nëse vini re që bletët e reja nuk dalin nga tuneli në hotel në fund të vitit të ardhshëm, larvat mund të kenë vdekur. Kjo mund të jetë shkaktuar për arsye të ndryshme (patogjenët, parazitët, kërpudhat etj). Në këtë rast, mund ta pastroni hotelin; që do të thotë të zëvendësoni kallamat e vjetër me të reja.

Seminar i përshtatur për moshat 9-13 vjeç

Pyetje të sugjeruara: Në opinionin tuaj, sa lloje bletësh ka në botë?

Kur ne mendojmë për bletët, secili nga ne zakonisht mendon vetëm për një lloj, bletët e mjaltit. Gjithsesi, ka mbi 20,000 lloje të ndryshme bletësh në botë. Të paktën 1,000 lloje jetojnë vetëm në Ballkan. Disa nga ato janë shumë të vogla (vetëm 5-8 mm të gjata), ndërkohë që disa të tjera janë mbi 2 cm të gjata (psh. Grerëzat apo bletët marangoz).

Pyetje të sugjeruara: Ku jetojnë bletët? Ku i bëjnë ato foletë?

Nga të gjitha llojet e bletëve në botë, vetëm një numër i vogël i tyre kanë një lloj social të organizimit, dhe vetëm disa nga ato jetojnë në koshere. Pjesa më e madhe e tyre jetojnë **të pavarura**. Çfarë do të thotë kjo saktësisht? Do të thotë që çdo femër ndërton një fole veçmas vetëm për veten e saj, ku vetëm ajo mund të lërë vezët.

Shumica e bletëve bëjnë foletë e tyre **nën tokë** (ato gërmojnë tunele në lloje të ndryshme toke). Disa lloje preferojnë zgavra në formën e tuneleve (psh, **zgavrat e kërcellit të bimëve** apo **tunele të braktisura në trungjet e pemëve të thara**, të gërmuara nga insektet e tjera). Ka disa lloje bletësh që janë të afta të gërmojnë në një pemë të thatë vetë. Në rajonin tonë, ndodhen disa lloje të cilat bëjnë foletë në **guacka kërmijsh boshe**. Ka nga ato që u pëlqejnë zgavrat me më shumë hapësirë (në tokë, trungjet e pemëve, shkëmbinj, objekte të ndryshme të bëra nga njerëzit). Është gjithashtu interesante të përmendim që disa lloje ndërtojnë fole të dukshme të jashtme, të ekspozuara, të ndërtuara me baltë/zhavorr apo rrëshirë.

Nëse ato gërmojnë tunele nëntokë, ato quhen **bletë gërmuese**. Nëse ato përdorin zgavrat në formën e tuneleve ekzistuese tek të cilat ato sjellin materiale të ndryshme të gjetura në natyrë dhe i përdorin për ndërtim ato, ato quhen **bletë ndërtuese**. Nëse ato mund të shpojnë tunele në pemë të thara, ato quhen **bletë marangoze**.

Pyetje të sugjeruara: Në opinionin tuaj, si jetojnë shumica e bletëve pavarësisht llojit të zgavrës në fjalë? A do ishit të interesuar të kuptonit se çfarë ndodh brenda një foleje bletësh?

Brenda një foleje bletësh, një femër ndërton dhoma të ndara të vogla, një për secilën vezë. Pranë vezës së lënë ajo lë një top ushqimi (një përzierje prej poleni dhe nektari) dhe më pas, duke përdorur materiale të ndryshme të gjetura në natyrë, ajo e izolon dhomën dhe fillon të përgatisë një tjetër. Pasi e gjithë hapësira në fole të jetë e zënë, ajo mbyll folenë dhe shkon të gjejë një fole tjetër. Për shkak të një jete kaq unike foletë e tyre nuk identifikohen kaq kollaj. Kjo është arsyeja pse shumica e njerëzve nuk e kanë idenë që bletët janë kudo rreth nesh. Në kontrast me këto lloje, foletë e bletëve sociale janë shumë të dukshme, gumëzhijnë nga aktivitetet e bletëve tashmë të rritura të gatshme të mbrojnë kolonitë e tyre. Bletët e pavarura kanë mungesë instikti për të mbrojtur foletë e tyre të vogla, dhe ato vetëm mund t'ju pickojnë nëse ju i kapni ato apo i shtypni (gjë që nuk ka gjasa ta bëni, edhe nëse e provoni).

Pyetje të sugjeruara: Ku ndodhen bletët meshkuj gjatë kësaj kohe? Çfarë bëjnë ato dhe si jetojnë?

Përgjegjësia e vetme që kane bletët meshkuj, është çiftëzimi me femrat. Pas çiftëzimit, femrat gjejnë një vend për fole për veten e tyre, e përgatisin atë, dhe sjellin ushqim. Meshkujt nuk marrin pjesë në këto aktivitete.

Mendohet që meshkujt nuk marrin pjesë në pjalmim pasi ato nuk mbledhin ushqim, që është poleni, për pasardhësit e tyre. Gjithsesi, meshkujt, vizitojnë lulet për të ushqyer veten e tyre dhe kështu marrin pjesë në pllenimin e luleve.

Udhëzimet për ndërtimin e një hoteli bletësh³:

Zgjidhni 15-20 kërcenj kallamash, por bëni kujdes që vrimat të kenë diametër të ndryshëm (përmasa) Zgjidhni disa kërcenj më të hollë, disa në përmasë mesatare dhe disa në përmasa më të mëdha (që do të thotë disa të hollë e disa kërcenj të jenë të trashë). Kjo siguron që bletët e përmasave të ndryshme do të vijnë në hotelin tuaj dhe do të bëjnë foletë aty (bletët e vogla në tunele më të vegjël dhe bletët e mëdha në tunele më të mëdhenj).

Sigurohuni që çdo kërcell ka një "mur të pasmë", dhe tuneli të mos ketë të dy anët fundore të hapura. Pra kur ju shikoni nëpërmjet vrimës, ajo duhet të jetë e mbyllur nga ana tjetër. Madje edhe nëse nuk keni kërcenj të kallamave të përshtatshëm, ju mund të përdorni disa materiale për ti bërë ato të përshtatshëm. Përdorni baltë për të izoluar fundin e një kallami, nëse është i hapur në të dy anët. Renditni ato së bashku, dhe lidhini me një lidhëse plastike. Nëse lidhësja është shumë e shkurtër, përdorni dy ose më shumë lidhëse të lidhura. Shtrëngojini ato fort.



Tashmë, hoteli është gati për tu instaluar. Ju mund të zgjidhni një vend për instalimin dhe sigurimin e tij me një tel apo me një litar.

³ Për fotografitë e materialeve në hotel, shikoni udhëzimet për ndërtimin e hotelit të përshtatur për moshat 5-8 vjeç.

Si të zgjedhim një vend të përshtatshëm për një hotel bletësh?

Një hotel nuk duhet të instalohet në tokë për shkak të lagështirës së madhe. Në mënyrë optimale ai duhet të instalohet të paktën 1 metër lartësi nga toka. Është e rëndësishme të instalohet në një vend ku të jetë i qëndrueshëm dhe të mos ju shqetësojë juve, por gjithashtu të jetë aq afër, sa që ju të mund të vëzhgoni aktivitetet rreth tij.

Zgjidhni një pjesë të siguruar nga shiu apo dëbora (apo ndërtoni një çati të vogël), por përsëri jo shumë me hije pasi bletët e duan diellin. Gjithsesi, provoni të gjeni një vend, i cili nuk është i ekspozuar gjatë gjithë ditës direkt në diell.

Pasi ta keni instaluar, mos e lëvizni më atë. Mos e futni brenda gjatë dimrit. Kjo mund të konfuzojë bletët brenda duke i bërë të mendojnë që pranvera apo vera ka ardhur. Kjo gjithashtu mund të shkaktojë zgjimin nga gjumi letargjik më herët se sa duhet.

Cila është koha optimale e vitit për të instaluar një hotel bletësh?

Një hotel bletësh mund të vendoset në çdo kohë të vitit. Gjithsesi koha optimale është në pranverën e hershme (kështu që është gati edhe për bletët e pranverës edhe ato të verës).

A është e nevojshme të pastrosh dhe të lëvizësh një hotel bletësh apo të kujdesesh për të në çdo mënyrë tjetër?

Pasi të keni vendosur një hotel bletësh, ju nuk do të keni më përgjegjësi. Nëse bletët bëjnë foletë e tyre gjatë pranverës dhe verës, thjesht shijojini ato duke i parë të punojnë fort. Pasi të mbarojnë foletë, ato do të vulosin hyrjen me materiale të ndryshme të gjetura në natyrë (kryesisht baltë dhe rrëshirë). Vitin e ardhshëm, bletët e rritura do të fluturojnë që këtu. Bletë të reja femërore, që dëshirojnë të bëjnë foletë e tyre atje përsëri, do të pastrojnë tunelet vetë dhe do ti përgatisin ato.

Prandaj, ju nuk keni nevojë të pastroni hotelin, ta sillni atë brenda apo të kujdeseni për të në mënyra të tjera.

Nëse ju vini re tufa shpendësh rreth hotelit, rekomandohet të vendosni një rrjetë në një lartësi të caktuar lart hotelit. Në këtë mënyrë, ju do të parandaloni shpendët që të ushqehen me larvat brenda.

Gjithashtu nëse vini re që bletët e reja nuk dalin nga tuneli në hotel në fund të vitit të ardhshëm, larvat mund të kenë vdekur. Kjo mund të jetë shkaktuar për arsye të ndryshme (patogjen, parazitë, kërpudhat etj). Në këtë rast, ju mund të pastroni hotelin, që do të thotë zëvendësoni kallamat me të reja.

Nëse pjesëmarrësit janë të interesuar të vazhdojnë diskutimin pasi hoteli është instaluar, gjeni këtu disa pyetje të sugjeruara nga ne:

Në opinionin tuaj, instalimi i vetëm një hoteli bletësh, a do t'i ndihmojë ato?

Lejoni pjesëmarrësit të mbërrijnë vetë në konkluzione. Përgjigje: Një hotel i vetëm nuk do të shpëtojë bletët ndërtuese, por ama sigurisht që ai mund ti ndihmojë shumë ato. Si rezultat i aktiviteteve të tyre, njerëzit kanë shkatërruar shume vende ku bletët mund të popullonin, kështu që një hotel bletësh është një zgjidhje e mirë për të siguruar që ato, të kenë vende të përshtatshme për të bërë fole në. Sa më pak kohë të harxhojnë duke kërkuar një vend të përshtatshëm, aq më shumë kohë do të kenë për të përgatitur foletë, për të sjellë ushqim dhe për të lënë vezët. Nëse ne u ofrojmë një hotel bletëve, ato kanë mundësinë për të lëshuar më shumë vezë.

Çfarë thamë në fillim? A përbën një hotel bletësh një rrezik për njerëzit?

Lejoni pjesëmarrësit të kujtojnë leksionin prezantues. Përgjigje: Hotelet e bletëve janë të banuara vetëm nga bletët e vetmuara, të cilat bëjnë jetë të pavarur; bletët femra ndërtojnë fole të veçanta për pasardhësit e tyre. Ato kanë mungesë instikti për të mbrojtur foletë e tyre kështu që është plotësisht e sigurt të ndërtohet një hotel bletësh në afërsi dhe ti vëzhgosh ato nga afër.



Seminari i përshtatur për moshën 13 vjeç (adoleshentë dhe të rritur)

Pyetje të sugjeruara: Në opinionin tuaj, sa lloje bletësh ka në botë?

Kur ne mendojmë për bletët, secili nga ne zakonisht mendon vetëm për një lloj, bletët e mjaltit (*Apis mellifera*). Gjithsesi, ajo çka mund të surprizojë shumë njerëz është fakti që ka mbi 20,000 lloje të ndryshme bletësh në botë. Të paktën 1,000 lloje jetojnë vetëm rajonin tonë, në Ballkan. Disa nga to janë shumë të vogla (vetëm 5-8 mm të gjata), ndërkohë që disa të tjera janë mbi 2 cm të gjata (psh. Bletët *Bombus* apo bletët marangoz)..

Pyetje të sugjeruara: Ku jetojnë bletët? Ku i bëjnë ato foletë e tyre?

Vetëm 10% e të gjitha llojeve të bletëve në botë kanë një lloj social të organizimit, dhe vetëm një numër i vogël i tyre jetojnë në koshere. Pjesa më e madhe e bletëve jetojnë **të vetmuara** (të pavarura), që do të thotë se çdo bletë femër ndërton një fole për veten e saj. Është e rëndësishme të përmendim që ka një gamë të gjerë të llojeve të organizimit kalimtare ndërmjet mënyrave sociale dhe të vetmuara të jetesës në botën e bletëve.

Shumica e bletëve bëjnë foletë **nën tokë** (ato gërmojnë tunele në lloje të ndryshme toke; disa madje zgjedhin një pjerrësi specifike të tokës). Disa lloje preferojnë zgavra në formën e tunelit të ngushta (psh. **vrmat e kërcellit të bimëve** apo **tunelet në trungjet e pemëve të thara të gërmuara nga insekte të tjera**). Ka disa lloje bletësh që janë të afta të gërmojnë në një pemë të thatë vetë. Në rajonin tonë, ndodhen gjithashtu disa lloje që bëjnë foletë e tyre në **guacka boshe kërmijsh**. Ka gjithashtu nga ato që pëlqejnë zgavra me hapësirë më të madhe (në tokë, trungje pemësh, shkëmbinj, objekte të ndryshme të ndërtuara nga njeriu etj) Është gjithashtu interesante

të përmendim që disa lloje bëjnë fole të dukshme/ të ekspozuara të ndërtuara me baltë, zhavorr apo rrëshirë.

Nëse ato gërmojnë tunelet nëntokë, quhen **bletë gërmuese**. Nëse ato përdorin vrimat në formën e tuneleve ekzistuese të cilat sjellin materiale të ndryshme të gjetura në natyrë dhe i përdorin për ndërtim, quhen **bletë ndërtuese**. Nëse ato shpojnë tunele në pemat e thata vetë, quhen bletë marangoze.

Pyetje të sugjeruara: Në opinionin tuaj, si jetojnë shumica e bletëve pavarësisht llojit të zgavrës? A do ishit të interesuar të kuptoni çfarë ndodh brenda një foleje?

Brenda një foleje bletësh, një femër ndërton dhoma të ndara të vogla, një për secilën vezë. Pranë vezës së hedhur ajo lë copë ushqimi (një përzierje prej poleni dhe nektari) dhe më pas, duke përdorur materiale të ndryshme të gjetura në natyrë, ajo e izolon dhomën dhe shkon të përgatisë një tjetër. Pasi e gjithë hapësira në fole të jetë e zënë, ajo mbyll folenë dhe shkon të gjejë një fole tjetër. Për shkak të një jete kaq unike, foletë e tyre nuk identifikohen kaq kollaj. Kjo është arsyeja pse shumica e njerëzve nuk e kanë idenë që bletët janë kudo rreth nesh. Në kontrast me këto lloje, foletë e bletëve sociale janë shumë të dukshme, gumëzhijnë nga aktivitetet e bletëve tashmë të rritura, të gatshme të mbrojnë kolonitë e tyre. Bletët e pavaruara kanë mungesë instikti për të mbrojtur foletë e tyre të vogla, dhe ato vetëm mund t'ju pickojnë nëse ju i kapni ato apo i shtypni (gjë që nuk ka gjasa që do ta bëni, edhe nëse e provoni).

Udhëzime për të ndërtuar një hotel bletësh⁴:

Zgjidhni 15-20 kërcenj kallamash, por bëni kujdes që vrimat të kenë diametër të ndryshëm (përmasa) Zgjidhni disa kërcenj më të hollë, disa në masë mesatare dhe disa në përmasa më të mëdha, (që do të thotë disa të hollë e disa kërcenj të jenë të trashë). Kjo siguron që bletët e përmasave të ndryshme do të vijnë në hotelin tuaj dhe do të bëjnë foletë aty (bletët e vogla në tunele më të vegjël dhe bletët e mëdha në tunele më të mëdhenj).

Sigurohuni që çdo kërcell ka një "mur të pasmë", tuneli nuk duhet të ketë të dy anët fundore të hapura, pra kur ju shikoni nëpërmjet vrimës, ajo duhet të jetë e mbuluar nga ana tjetër. Madje edhe nëse nuk keni kërcenjtë e kallamave të përshtatshëm, ju mund të përdorni disa materiale për ti bërë ato të përshtatshëm. Përdorni baltë për të mbyllur fundin e një kallami, nëse është i hapur në të dy anët.

Renditni ato së bashku, dhe lidhini me një lidhëse plastike. Nëse lidhësja është shumë e shkurtër, përdorni dy ose më shumë lidhëse të lidhura. Shtrëngojini ato fort.

4 Për fotografitë e materialit dhe hotelit, lutem shikoni udhëzimet e ndërtimit të hotelit përshtatur për moshën 5-8 vjeç



Si të zgjedhim një vend të përshtatshëm për një hotel bletësh?

Një hotel nuk duhet të instalohet në tokë për shkak të lagështirës së madhe. Optimalja është që ai duhet të instalohet të paktën 1 metër lartësi nga toka. Është e rëndësishme të instalohet në një vend ku të jetë i qëndrueshëm dhe të mos ju shqetësojë juve, por gjithashtu të jetë aq afër saqë ju të mund të vëzhgoni aktivitetet rreth tij.

Zgjidhni një pjesë të siguruar nga shiu apo dëbora (apo ndërtoni një çati të vogël), por përsëri jo shumë me hije pasi bletët e duan diellin. Gjithsesi, provoni të gjeni një vend, i cili nuk është i ekspozuar gjatë gjithë ditës direkt në diell.

Pasi ta keni instaluar, mos e lëvizni më atë. Mos u futni brenda gjatë dimrit. Kjo mund të konfuzojë bletët brenda duke i bërë të mendojnë që pranvera apo vera ka ardhur. Kjo gjithashtu mund të shkaktojë zgjimin nga letargjia më herët se sa duhet.

Cila është periudha optimale e vitit për të instaluar një hotel bletësh?

Një hotel bletësh mund të vendoset në çdo kohë të vitit. Gjithsesi koha optimale është në pranverën e hershme (kështu që është gati edhe për bletët e pranverës edhe ato të verës).

A është e nevojshme të pastrosh dhe të lëvizësh një hotel bletësh apo të kujdesesh për të në çdo mënyrë tjetër?

Pasi të keni vendosur një hotel bletësh, ju nuk do të keni më përgjegjësi. Nëse bletët bëjnë foletë e tyre gjatë pranverës dhe verës, thjesht shijojini ato duke i parë të punojnë fort. Pasi të mbarojnë foletë, ato do të izolojnë hyrjen me materiale të ndryshme të gjetura në natyrë (kryesisht baltë dhe rrëshirë). Vitin e ardhshëm, bletët e rritura do të fluturojnë që aty. Bletë të reja femërore, që dëshirojnë të bëjnë foletë e tyre atje përsëri, do të pastrojnë tunelet vetë dhe do ti përgatisin ato.

Prandaj, ju nuk keni nevojë të pastroni hotelin, ta sillni atë brenda apo të kujdeseni për të në mënyra të tjera.

Nëse ju vini re tufa shpendësh rreth hotelit, rekomandohet që të vendosni një rrjetë në një lartësi të caktuar lart hotelit. Në këtë mënyrë, ju do të parandaloni shpendët që të ushqehen me larvat brenda.

Gjithashtu nëse vini re që bletët e reja nuk dalin nga tuneli në hotel në fund të vitit të ardhshëm, larvat mund të kenë vdekur. Kjo mund të jetë shkaktuar për arsye të ndryshme (patogjen, parazitë, kërpudhat etj). Në këtë rast, ju mund të pastroni hotelin, që do të thotë të zëvendësoni kallamat me kallama të reja.

Në rast se pjesëmarrësit janë të interesuar të vazhdojnë diskutimin pasi hoteli është instaluar këtu gjeni disa pyetje të sugjeruara nga ne:

Në opinionin tuaj, a është instalimi i një hoteli të vetëm ndihmë për bletët?

Lejoni pjesëmarrësit të dalin vetë në një konkluzion. Përgjigje: Një hotel i vetëm nuk do të shpëtojë bletët ndërtuese, por sigurisht që ai do ti ndihmojë shumë ato. Si rezultat i aktiviteteve të tyre, njerëzit kanë shkatërruar shume vende ku bletët mund të populloheshin ndryshe, kështu që një hotel bletësh është një zgjidhje e mirë për të siguruar që ato të kenë vende të përshtatshme për të ndërtuar fole. Sa më pak kohë të harxhojnë duke kërkuar një vend të përshtatshëm, më shumë kohë do të kenë për të përgatitur foletë e tyre, për të sjellë ushqim dhe të hedhin vezët. Nëse ne u ofrojmë një hotel bletësh ato kanë mundësinë për të hedhur më shumë vezë.

Çfarë thamë ne në fillim? A përbën një rrezik për njerëzit një hotel bletësh?

Lejoni pjesëmarrësit të kujtojnë leksionin prezantues. Përgjigje: Hotelet e bletëve banohen vetëm nga bletët e vetmuara, të cilat bëjnë jetë të pavarur dhe femrat e të cilave ndërtojnë fole të veçanta për pasardhësit e tyre. Ato kanë mungesë instikti për të mbrojtur foletë e tyre, kështu që është plotësisht e sigurt të ndërtosh një hotel bletësh në afërsi dhe ti vëzhgosh ato nga afër.

Çfarë ndodh nëse një bletë futet në një dhomë?

Nëse bleta hyn në dhomë, nuk ka nevojë për të përhapur panik. Bletët përbëjnë rrezik vetëm nëse ato janë në afërsi të folesë së tyre, dhe kjo nuk u referohet të gjithë llojeve të bletëve, por vetëm bletëve sociale. Një bletë e vetme në një dhomë nuk ka arsye t'ju sulmojë. Mjafton të hapni dritaren, fikni dritën, lëvizni perden dhe ta ndihmoni të dalë jashtë.

Nëse ndodh që ka më shumë bletë në dhomë në të njëjtën kohë, është e mundur që mund të ketë një fole aty afër. Është e ditur që bletët e egra të mjaltit mund të banojnë në pjesën e drunjtë të dritareve, një zgavër trugu peme (e cila mund të jetë afër me dritaren tuaj), një zgavër në fasadë apo në një oxhak që nuk përdoret më. Në rast se diçka e tillë ndodh, kontaktoni shoqatën e bletëritësve dhe kërkonj këshilla apo ndihmë.

Çfarë të bëjmë nëse një bletë na pickon?

Nëse një bletë ju pickon, thumbi apo gjembi i saj mbase ka mbetur në lëkurën tuaj. Rekomandohet që ju ta hiqni thumbin me kujdes (sa më shpejt të jetë e mundur) dhe vëzhgoni ndryshimet rreth vendndodhjes së thumbit. Skuqje lokale, dhimbje dhe enjtje mund të ndodhin. Dhimbja mund të zgjasë disa ditë. Sigurisht, disa njerëz mund të jenë alergjikë ngaj thumbit të bletës së mjaltit dhe ato duhet të marrin trajtim të menjëhershëm.

Edhe nëse nuk keni një reaksion alergjik, por vendi i thumbit është afër zonës së qafës apo afër rrugëve të frymëmarrjes, rekomandohet që ju të kërkonj ndihmë të menjëhershme mjekësore pasi nuk mund të jeni i sigurt që ndonjë enjtje në këtë vend do të ndikojë në frymëmarrje apo jo.

Nëse nuk jeni pickuar nga një bletë mjalti, por nga një lloj tjetër blete, nuk ka nevojë të shqetësoheni. Thumbi i tyre nuk qëndron në lëkurë pas pickimit. Dhimbja dhe skuqja zakonisht ikën shpejt. Është e rëndësishme të dini që njerëzit mund të jenë alergjikë vetëm ndaj thumbit të bletës së mjaltit.

Çfarë duhet të bëj nëse vë re një tufë bletësh?

Fillimisht duhet të kuptoni se çfarë keni parë aktualisht; shumë bletë që fluturojnë në ajër apo një grup bletësh që qëndrojnë akoma në një vend?

Kur ne themi “një tufë bletësh” – zakonisht i referohemi situatës së fundit. Çfarë po bëjnë bletët aty? Është një fenomen natyror në të cilin një koloni bletësh mjalti ndahet në dy grupe. Në këtë

rast, mbretëresha ekzistuese e kolonisë së vjetër, së bashku me gjysmën e bletëve që ndjekin atë. Mbretëresha do të ndalojë diku aty afër (psh. Në një degë peme) dhe bletët e tjera punëtore, vajzat e saj besnike, do të formojnë një "mburojë të gjallë". Një numër i caktuar i bletëve punëtore do të përhapen në drejtime të ndryshme (këto quhen "bletët zbuluese"), për të kërkuar një koshere të re në të cilën tufa e bletëve do të jetojë. Kur ato kthehen, përcjellin informacionin mbi zgavrën që kanë gjetur, dhe fillojnë udhëtimin drejt vendit të gjetur. Ndërkohë në koloninë e vjetër, gjysma tjetër e bletëve punëtore që kanë qëndruar do të fillojnë të ushqejnë mbretëreshën e re e cila do të marrë udhëheqjen e kosheres.

Prandaj, lulëzimi i bletëve është një fenomen natyror i ndarjes së kolonisë së bletës dhe nuk duhet të frikësohemi nga kjo gjë. Një numër i madh bletësh të grupuara së bashku mund të tingëllojë i frikshëm, por zakonisht ato nuk janë të rrezikshme në një formacion të tillë. Mos i shqetësoni ato, dhe do të largohen për pak orë ose më e shumta për pak ditë. Nëse ndodh që të lulëzojnë në një vend të mbushur plot me njerëz, ku mund ti shqetësojnë ato, kontaktoni shoqatën e bletërritësve dhe kërkon ndihmë. Mos provoni ti zhvendosni apo ti largoni vetë. Kjo mund ti inatosë dhe mund t'i sillni telashe vetes suaj dhe të tjerëve.



Përgjigjet e duhura:



Qarkoni mizat
Shënoni bletët ✓
Nënvizoni grerëzat





Zonat e Mbrojtura për Natyrën dhe Njerëzit



Pse jemi ne këtu:

Për të punuar për një botë natyrore të qëndrueshme në dobi të njerëzve dhe jetës së egër.

wwfadria.org



www.facebook.com-wwfadria

© 2021.

© Simboli i pandës ® „WWF” Fondi Botëror për Natyrën (dikur Fondi Botëror i Kafshëve të Egra) “WWF” është një markë tregtare e regjistruar nga WWF